



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.277/22

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit "M...." shpk me seli ne Lipjan, ish fabrika C.C., me numër identifikues ndaj debitorit "NTP "F..." me numër identifikues ..., te cilin e përfaqëson K.B. B.I, me seli ne rr."...." p.n në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.856/21, të datës 21.10.2021, me datë 09.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit NTP "F..." me numër identifikues ..., te cilin e përfaqëson K.B. B.I, me seli ne rr."...." p.n, në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.856/21, të datës 21.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.856/21, të datës 21.10.2021, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit NTP "F..." me numër identifikues ..., me seli ne rr."...." p.n, në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson K.B. B.I, i ushtruar kundër urdhrorit për përmbarim P.nr.1033/21 të datës 14.06.2021, i lëshuar nga përmbaruesi privat i Isa Gacaferri, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendies faktike dhe shkeljeve te dispozitave ligjore, me propozim që Gjykata e shkalles se dytë, ta aprovoj si të bazuar ankesën e debitorit, ndërsa aktvendimin e ankimuar ta prish ashtu qe lëndën ta kthej në rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave me nr.5-2/104116 dt.14.11.2020, 5-2/104117 dt.14.11.2020, 1-2/255455 dt.14.11.2020, 1-2/255456 dt.14.11.2020, 1-2/255555 dt.16.11.2020. Përmbaruesi privat Isa Gacaferri nga Prishtina, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.1033/21 të datës 14.06.2021, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit, t'ia paguajë shumën prej 1,779.43 euro, me kamatëvonesë prej 8% në vit.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 21.06.2021, duke theksuar se me kreditorin kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi në cilësinë e operatorit ekonomik, janë pajtuar që bazuar në rregullat e moralit afarist në çdo fundvit apo fillim të vitit të ardhshëm kalendarik të bëjnë barazimin në koordinim të përbashkët për konfirmimin e saldove financiare. Është në kundërshtim me marrëveshjen tonë që të kërkohet çfardo kompenzimi i mjeteve pa barazimin e obligimeve të operatoreve ekonomik, pra kemi të bëjmë me shkelje të nenit 27 par.1 dhe 29 par.3 si dhe nenit 32 par.1 të LPP. Kreditori nuk ka treguar gatishmëri që në bashkëpunim me debitorin ti përmbahet marrëveshjes, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin dhe ta prish urdhrin për përmbarim duke abroguar të gjitha veprimet juridike.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, pas vlerësimit të prapësimin, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.856/21 të datës 21.10.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se pretendimet e paraqitura nga debitori janë të pabazuara dhe në kundërshtim me shkresat që gjinden në lëndë, pasi propozimi për përmbarim është bërë në bazë të dokumentit të besueshëm dhe atë konform nenit 38 par.1 të LPP. Nga shkresat në lëndë shihet që debitori ka pranuar faturat e derguara nga kreditori, andaj pretendimet e debitorit janë në kundërshtim me shkresat në lëndë dhe në bazë të nenit 69.4 të LPP u vendos si në dispozitiv të vendimit. Gjykata e shkallës së parë është thirrur edhe në nenet 245 par.1 dhe 2 dhe 249 par.1 dhe 2 të LMD, dhe se debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të prapësimin të tij konform nenit 71 të LPP.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale nisur nga kjo gjendje vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për çka edhe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se vendimi i shkallës së parë është bazuar në dokument të besueshëm, konform nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku

përcakton se “përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm, më tutje ky nen parasheh se “dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, e që në rastin konkret dokument i besueshëm janë edhe faturat nr.5-2/104116 dt.14.11.2020, 5-2/104117 dt.14.11.2020, 1-2/255455 dt.14.11.2020, 1-2/255456 dt.14.11.2020, 1-2/255555 dt.16.11.2020, për shumën e detyrimit prej 1,779.43 euro, e mbi bazën e të cilave është caktuar përmbarimi. Pretendimi i debitorit se faturat e këtij rasti nuk janë të përshtatshme si dokument përmbarimor, nuk qëndron sepse nga faturat në lëndë rezulton me faktin se debitori i ka nënshkruar të njëjtat konsiderohet se e ka pranuar kështu edhe detyrimin ndaj kreditorit. Poashtu pretendimi i debitorit se kreditori nuk e ka përmbushur detyrimin për barazimin e saldove financiare nuk qëndron, sepse kreditori me shkresën 000454, të datës 31.12.2020 i është drejtuar debitorit “duke iu referuar regjistrimeve në librat tona për vitin 2020 rezulton se balanca e llogarive tuaja të pagushme ndaj M... shpk, me datën 31.12.2020 është si më poshtë, nëse kjo vlerë nuk përputhet me rexhistrimet tuaja ju lutem konfirmojeni këtë duke e nënshkruar”, të cilën shkresë debitori e ka nënshkruar dhe vulosur, nga del se kreditori ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 245 par.1 dhe 2 si dhe 249 par.1 dhe 2 të LMD. Edhe kjo gjykatë vlerëson se debitori nuk ka arrit që prapësimi t’ia bashkangjes provat konkrete përkitazi pretendimeve të tij, ashtu siç parashihet me nenin 69.4 të LPP, andaj nuk janë plotësuar arsyet ligjore nga neni 71 par.1 të LPP për të vendosur ndryshe, dhe nuk ka kushte për anulim të urdhrit përmbarimor.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha më lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE-DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.277/22, me datë 09.11.2022

Gjyqtarja
Franciska Zhitija-Ymeri